



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

VENDIM

Nr 38 datë 31.05.2022

MBI

“MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE, TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (SOT ASHK) PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PARA NOTERIT”

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 2, 23 e vijues, në ligjin nr.9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndyshuar, neni 35, në ligjin nr.9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.97, datë 03.02.2008 “Për procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, pika 3 e vijues, Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë, në mbledhjen e datës 31/05/2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të përfundohen procedurat e privatizimit të apartamenteve, përkatësisht lidhja e kontratave të shitblerjes para noterit, banesat e të cilëve kane mbetur pa u regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastrë, për qytetarët si më poshtë:

| Nr. | ADRESA | EMRI MBIEMRI |
|-----|---|--------------|
| 1 | Lagjia “Blloku i Furrave, ish konvikti i punëtorëve të N N” | Emin Habipi |

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Gjirokastrës ose personi i autorizuar prej tij për lidhjen e kontratës së privatizimit.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT

Lavdi Hasani

